



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

DOGANA KOSOVËS
CARINA KOSOVA
KOSOVO CUSTOMS

Nr. Ref. KPK /nr. 1452/2022

Nr. Ref. _____

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK)

dhe

DOGANËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 2022

Neni 1 Palët

- 1.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës (tani e tutje "KPK"), adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Jetish MALOKU, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- 1.2 Dogana e Kosovës (tani e tutje "DK"), adresa në: Rr. "Rexhep Krasniqi" nr.1, Lagja Kalabria, Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Agron LLUGALIU, Drejtor i Doganës së Kosovës.

Neni 2 Objekti i memorandumit

Objekt i këtij memorandumit është ndërlidhja e sistemeve elektronike dhe shkëmbimi i të dhënave në formë elektronike në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Doganës së Kosovës.

Neni 3 Qëllimi i memorandumit

- 3.1 Qëllimi i këtij memorandumit është rregullimi dhe përcaktimi i procedurave për shkëmbimin e të dhënave në formë elektronike nga sistemet për menaxhimin e lëndëve
- 3.2 Të gjitha të dhënat nga DK në prokurori do të dërgohen në formë elektronike nga sistemet e tyre (LES_ECM të DK-së dhe sistemit SMIL të KPK-së) për menaxhimin e lëndëve dhe anasjelltas.

Neni 4 Përgjegjësitë e palëve

- 4.1 KPK dhe DK obligohen në formimin e një grupi të përbashkët për përcaktimin dhe mënyrën e shkëmbimit të të dhënave nga sistemet elektronike.
- 4.2 Grupi i përbashkët ka për obligim përgatitjen e Procedurës Standarde të Veprimt (tani e tutje PSV), e cila përmban të dhënat që do të shkëmbehen.

Neni 5 Nënshkrimi i PSV-së

Me përfundimin e PSV-së për shkëmbimin e të dhënave, dhe me aprovimin e menaxhmentit të KPK-së dhe DK-së, nënshkrimi i PSV-së do të bëhet nga udhëheqësit e departamenteve të teknologjisë informative.

Neni 6 **Kualiteti i të dhënave**

Palët nënshkruese mbajnë përgjegjësi për saktësinë e të dhënave, të cilat shkëmbehen në mënyrë elektronike mes dy sistemeve.

Neni 7 **Mbajtja e takimeve**

KPK dhe DK, përkatësisht, departamentet gjegjëse të teknologjisë informative, do të mbajnë takime të rregullta në rast të avancimit të sistemeve, me qëllim të njoftimit dhe mënyrës së shkëmbimit të të dhënave.

Neni 8 **Shkëmbimi i informacioneve**

Palët nënshkruese të këtij memorandumi garantojnë konfidencialitetin e çdo informacioni që administrohet dhe shkëmbehet nga sistemet në pajtim me ligjin.

Neni 9 **Mbikëqyrja e memorandumit**

Vënia në zbatim e këtij memorandumi do të mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga udhëheqësit e Departamenteve të Teknologjisë Informative, duke përpiluar raporte të veçanta të cilat përcillen te menaxhmenti i KPK dhe DK.

Neni 10 **Faza kalimtare**

- 10.1 Krahas shkëmbimit të të dhënave në formë elektronike nga sistemet, në të njëjtën kohë do të bëhet shkëmbimi edhe në formë fizike.
- 10.2 Shkëmbimi i të dhënave njëkohësisht fizike dhe elektronike bëhet me qëllim që të dhënat e dërguara të jenë të sakta dhe stafi është duke e përdorë sistemin në mënyrë të kënaqshme.
- 10.3 Largimi i kopjes fizike (lëndës) do të bëhet pas vlerësimit të KPK-së dhe DK-së, të cilat do të përgatisin një raport të veçantë me propozime konkrete, i cili do të dërgohet për aprovim nga ana e tyre.

Neni 11
Hyrja në fuqi

- 11.1 Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët, ndërsa do të fillojë të zbatohet në momentin që sistemet elektronike të palëve janë në funksionim dhe përdorim.
- 11.2 Memorandumi do të nënshkruhet në katër (4) ekzemplarë origjinalë, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.
- 11.3 Palët mund të bëjnë plotësime dhe ndryshime të nevojshme të këtij memorandum në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

Palët nënshkruese

Datë 23.11.2022.

Këshilli Prokurorial i Kosovës



z. Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Dogana e Kosovës



z. Agron Llugaliu

Drejtor i Doganës së Kosovës